



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

**SAMITI I KRYETARËVE TË KOMISIONEVE PËR POLITIKË TË JASHME TË  
PARLAMENTEVE**  
**TË VENDEVE TË EVROPËS JUG-LINDORE**

Prishtinë, 20 shtator 2010

**DEKLARATË**

Të mbledhur në Samitin e Kryetarëve të Komisioneve për Politikë të Jashtme të Parlamenteve të Evropës Jug-Lindore, të mbajtur në Prishtinë më 20 shtator 2010, kryetarët e përfaqësuesit e Komisioneve të Politikës së Jashtme të vendeve të rajonit: Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Turqi e Kosovë, në mbarim të diskutimit për “ Bashkëpunimin rajonal dhe integrimet evropiane”, miratuan këtë deklaratë:

1. Shprehim përkushtimin për intensifikimin e bashkëpunimit ndër-parlamentar rajonal në të gjitha fushat e veprimtarisë parlamentare;
2. Përkrahim fuqishëm politikat e integrimi Euro-Atlantike dhe bashkëpunimin për arritjen e standardeve demokratike dhe të vlerave evropiane;
3. Angazhohemi për lëvizje të lirë të qytetarëve në hapësirën evropiane dhe përkrahim liberalizimin e vizave për qytetarët e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor;
4. Shprehim qëndrimin që pavarësia e Kosovës është bërë faktor i stabilitetit në rajon, duke hapur perspektiva për integrimi rajonale dhe evropiane dhe, me këtë synim, ftojme vendet fqinje e të tjerët që ta njohin pavarësinë e Kosovës;

5. Mbetemi të përkushtuar për promovimin e dialogut në interes të popujve e të shteteve të rajonit dhe në frymën e Rezolutës së Asamblesë së OKB-së të datës 9 shtator 2010, inkurajojmë dialogun në mes të Kosovës e të Serbisë për çështje të interesit të përbashkët.

Prishtinë, 20 shtator 2010

Sabri Hamiti (Kosovë)

Fatos Beja (Shqipëri)

Dobroslav Dimitrov (Bullgari)

Krešimir Čosić (Kroaci)

Teuta Arifi (Maqedoni)

Miodrag Vukovic (Mali i Zi)

Mehmet Ceylan (Turqi)